



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi

VENDIM

Nr. 90, datë 31.05.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E DRAFT KONTRATËS
NDËRMJET “KESH”SHA DHE “OSHEE”SHA, PËR SHIT-BLERJEN E SASISË SË
TEPËRT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË REZULTON PAS PËRMBUSHJES SË
KËRKESËS SË KLIENTËVE QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI UNIVERSAL ME
QËLLIM MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR
PERIUDHËN KOHORE 01.01.2019 – 31.12.2019**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshur; nenit 5 të VKM-së nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e “Kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit transmetimi, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” i ndryshuar; nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.05.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, lidhur me “Fillimin e procedurës për miratimin e draft kontratës ndërmjet “KESH”sha dhe “OSHEE”sha, për shit-blejjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klienteve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019”,

Konstatoi se:

- Në shkresat me nr. 2264/1 Prot, dhe nr. 2264 Prot, datë 13.05.2019, protokolluar me tonat nr. 340/1, datë 15.05.2019 dhe nr. 340, datë 15.05.2019, është paraqitur për miratim pranë ERE-s, “draft kontratës ndërmjet “KESH”sha dhe “OSHEE”sha, për shit-blejjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019”.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 16, datë 18.02.2019 mbi “Shtyrjen e afatit të zbatimit të “Kontrates tip për shit-blejjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a për periudhën

01.01.2018 – 31.12.2018”, dhe “Kontratës për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klienteve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2018-31.12.2018”, pika 1 e tij vendosi:

1. *Shtyrjen e afatit të zbatimit të Kontratës për shit – blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, miratuar me Vendimin e ERE-s nr. 98, datë 30.04.2018, deri në paraqitjen e draft kontratës për vitin 2019 nga KESH sha dhe OSHEE sha, dhe miratimin e saj nga ERE.*
- Me shkresën me nr. 176/1 prot, datë 06.03.2019 dërguar shoqërive “KESH” sh.a. dhe “OSHEE” sh.a., ERE ka bërë me dije palët se: “shtyrja e afatit të kontratave të miratuara me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 16, datë 18.02.2019 erdhi si rrjedhojë e konstatimeve mbi mungesën e dakordësisë mes palëve për nënshkrimin e kontratave të vitit 2019
 - Gjithashtu në korrespondencën sa më sipër cituar, ERE u ka bërë me dije palëve se mungesa e kontratave të dakordesuara nuk i çliron palët (KESH sha dhe OSHEE sha) nga detyrimi për të depozituar në ERE për miratim këto kontrata në përmbushje të parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
 - Në përgjigje të korrespondencës sa më sipër, u paraqit për miratim në ERE “draft kontratës ndërmjet “KESH”sha dhe “OSHEE”sha, për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019
 - Nga shqyrtimi i kontratës së paraqitur dhe të dakordësuar e nënshkruar mes OSHEE sh.a. dhe KESH sh.a., për vitin 2019 konstatohet se ka ndryshime nga kontrata e miratuar në 2018, të cilat konsistojnë në nenin 4.

Në konkluzion duke konstatuar :

- të drejtën e ERE-s për miratimin e Kontratës ndërmjet “KESH”sha dhe “OSHEE”sha, për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019” në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; nenit 5 të VKM-së nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e “Kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit transmetimi, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” i ndryshuar; dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit dhe funksionimit të ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr.96, datë 17.06.2016, i propozojmë Bordit të ERE:
- dakortësinë e palëve me njëra-tjetrën mbi “Kontratën ndërmjet “KESH”sha dhe “OSHEE”sha, për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019”, e pasqyruar kjo në nënshkrimin e saj nga palët.

- KESH sh.a. legjitimohet si palë në rolin e prodhuesit të energjise elektrike dhe OSHEE sh.a. në rolin e Operatorit të Ssitemit të Shpërndarjes së Energjisë elektrike.
- Per ndryshimet e konstatuara në kontratë që konsistojnë në neni 4, do t'u kërkohet informacion palëve lidhur me arsyet e ndryshimeve dhe përputhshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Kontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019”.
2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

Petrit AHMETI